



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 47
Prishtinë, më 18 qershor 2010
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-302
Mbledhja filloi në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L

I dëgjimit publik të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Basri Musmurati, Zylfi Merxha dhe Radmila Vujoviq - anëtarë të Komisionit.

Mungoi: Lulzim Zeneli, Eqrem Kryeziu, dhe Suzana Novoberdaliu - anëtarë të Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Antigona Ibraj, Nuredin Ibishi dhe Afrim Hoti.

Dëgjimin publik e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Dëgjim publik lidhur me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, prezanton Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, z.Bajram Rexhepi

Kryetari i Komisionit – Ju uroj mirëseardhje dhe ju falënderoj për raportin e sjellë me shkrim. Sot do të diskutojmë për pikat e raportit të progresit që janë detyrë e Komisionit që ti shqyrtojë. Anëtarët e komisionit janë të lirë të shtrojnë pyetje në lidhje me këto pika

që janë parashtruar si pyetje MPB-së. Paraprakisht desha t'ju them që jam i kënaqur me raportin e sjellë nga ju dhe ju ftoj që të raportoni.

Bajram Rexhepi – Ju faleminderit. Ne shprehim gatishmërinë në çdo kohë kur Komisioni shpreh interesim të raportojmë qoftë me shkrim apo drejtpërdrejtë për sfidat dhe punën që ne bëjmë. Këtu jemi të ftuar për pikat e raportit të progresit të Komisionit Evropian, ku ne mund të raportojmë në lidhje me raportin e sjellë në pika të shkurta. Ne mund të ju njoftojmë për punët që bën Ministria, përveç punës që ndërlidhen me sundimin e rendit dhe ligjit, për luftën kundër korrupsionit. Ne prioritet e kemi procesin e liberalizimit të vizave, dhe në këtë drejtim kemi arritur mjaft sukses. Sa i përket menaxhimit të integruar të kufijve, desha të ju informoj se intraneti i shpërndarë në të gjitha pikat kufitare, duke përfshirë edhe pikën 1 dhe 31 të cilat së bashku përcjellën në një qendër. Sistemet informative në pikat kufitare janë duke u instaluar. Një sistem është i Komisionit Evropian dhe një sistem tjetër është amerikan, dhe ne kemi kërkuar që këto dy sisteme të harmonizohen.

Ne kemi bashkëpunim të ngushtë me Shqipërinë si kusht i Komisionit Evropian, por besoj që shumë shpejtë do të marrim kompetencat për menaxhimin e integruar të kufijve me Maqedoninë por jo në krejt kufirin për shkak se ende nuk kemi kapacitete. Njëjtë do të veprojmë edhe me Malin e Zi. Me Shqipërinë përveç marrëveshjeve të shumta që janë lidhur, kemi lidhur edhe një marrëveshje për Policinë rrugore gjatë tre muajve të sezonës verore. Policët tanë dhe Policët nga Shqipëria do të patrullojnë së bashku për sigurinë në trafik.

Një prej çështjeve tjera janë dokumentet civile, si parakusht që regjistri civil të themelohet në mënyrë që të prodhojnë i pasaportave biometrike. Mund të them se rreth 70 % është bërë digjitalizimi i të dhënave gjendjes civile nëpër komuna. Një ndihmë të madhe e kemi pas nga Ministria e Punëve të Brendshme nga Shqipëria si modeli më i mirë.

Ju e dini se Projektligji për Ripranim ka kaluar në lexim të parë, dhe shfrytëzoj rastin pasi që ky është ligj fleksibil, kisha kërkuar që një përfaqësues nga MPB-ja, të jetë në rolin e vëzhguesit. Dhe krejt për fund, ne jemi optimist se në vitin 2011, ne do të plotësojmë kushtet për procesin e liberalizimit. Ndërsa sa i përket luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, shihet një dinamikë e shtuar kohët e fundit, dhe rezultatet janë më inkurajuese.

Kryetari i Komisionit – Raporti i progresit është instrument thelbësor i vlerësimit të progresit të vendeve që prosperojnë drejt integritetit evropian. Çdo fundvit Komisioni Evropian përmes këtij instrumenti analizon përparimin e çdo vend kandidat për përmbushjen e kriterëve dhe detyrimeve që rrjedhin nga Parlamenti Evropian. Si sfida për Kuvendin e Kosovës ka qenë rritja e mbikëqyrjes parlamentare. Ka një qasje të re prej kohës që ka ardhur Ministri z. Bajram Rexhepi. Kemi pas raporte nga Ministria për reformat dhe sfidat që ka MPB-ja. Sa i përket Projektligjit për Ripranim grupi punues e ka shqyrtuar dhe kemi mbajtur një dëgjim publik. Në dëgjim publik është vlerësuar se nuk ka nevojë për ndërhyrje, përveç ndërhyrjeve të natyrës teknike.

Bajram Rexhepi – Ne e kemi një kërkesë për Komisionin në lidhje me Ligjin për Inspektoratin e Policisë. Me këtë Ligj ata fitojnë kompetenca të mëdha si hetimin brenda

Policisë edhe për procedura penale. A keni mundësi të loboni që para pushimeve të Kuvendit, ky ligj të hyjë në procedurë për arsye se është i një rëndësie të veçantë.

Zylfi Merxha – Unë përfaqësoj komunitetin rom në këtë komision dhe desha të di se si po shkon puna me minoritetet? Një çështje që duhet të trajtohet me kujdes është nënshkrimi i marrëveshjes për kthimin e rreth 15 000 romëve nga Gjermania në Kosovë. Kjo mua do të më shkaktonte problem politik dhe social. Desha të di më shumë për këtë çështje se çka është duke u ndërmarr?

Bajram Rexhepi –Sa i përket përfaqësimit të komunitetit rom në Policinë e Kosovës, numri është i arritur. Ndërsa sa i përket çështjes së ripranimit këto shqetësime që përmendi z.Merxha kanë qenë para nënshkrimit të marrëveshjes, dhe për momentin mund t'i deportojmë në baza vullnetare. Ne kemi strategjinë për integrim e cila ka kaluar nga Qeveria në Parlament. Kemi gatishmëri nga shtete të ndryshme që të ndihmojnë me fonde të caktuara dhe projekte të caktuara. Pas kthimit të tyre qoftë në aeroport apo në pika kufitare MPB-ja do ti pres dhe pastaj secila Ministri i ka detyrat e veta.

Radmila Vujović - Gjithë këtë që ju e thatë për planet dhe iniciativat e juaja do të ishte mirë që të jenë funksionale, sepse këtu janë në pyetje qytetarët. Andaj rritja e besimit të qytetarëve për Policinë e Kosovës, do të ishte mirë edhe për ju. Sa i përket ligjit, iniciativa vije nga ju, dhe pastaj kalon nëpër komision ku bëhet edhe shqyrtimi. Gjithë propozimet që ju mendoni që janë të nevojshme ne do ti mirëpresim. Që ligji të jetë sa më i zbatueshëm, ne si komision do të insistojmë që këto propozime ti inkorporojmë vetëm që ligji të jetë sa më funksional dhe të mos mbeten dokumente të shkruara.

Basri Musmurati –Unë kam një shqetësim në lidhje me disa fshatra të komunës së Kamenicës. Këtu kemi një kontest të rrugës së asfaltuar që i lidh këto fshatra, dhe, një marrëveshje me KFOR-in është kinse kjo pjesë i takon Serbisë, e në fakt kjo pjesë i takon banorëve shqiptar. E shtrova këtë çështje që të dimë se çka ka mundësi të bëhet më shumë në këtë drejtim?

Shkumbin Demaliaj – Besoj që përveç takimeve për çështje të jashtëzakonshme do të kemi rast të takohemi edhe për çështjet që i kemi për detyrë si komision, si monitorimin e ligjeve brenda kësaj Ministrie. Një çështje mjaft me rëndësi është se një numër i madh i poseduesve të automjeteve që kanë hyrë kohët e fundit në Kosovë nuk janë të pajisur me tabela. A ka nxjerr Ministria ndonjë udhëzim në lidhje me këtë çështje apo do të vazhdojë me udhëzimet e UNMIK-ut të nxjerra më parë.

Nëse kjo Ministri nuk mund ta ushtrojë funksionin e vet në Veri, ka një numër të madh të automjeteve që nuk janë të pajisur me tabela dhe po qarkullojnë lirshëm nëpër rrugët e Kosovës, kjo i kushton shumë buxhetit të Kosovës.

Bajram Rexhepi – Këtu kam ardhur me qëllimin që kredibiliteti për Policinë e Kosovës, si pjesë vitale e Ministrisë, të rritet efikasiteti i tyre dhe këto ndryshime të vërehen. Ka shumë sfida por këto do të tejkalohen dhe besimi do të rritet. Ne kemi vizituar stacionin policor në Kamenicë, por edhe në Ranillug ku kemi filluar përgatitjet për një stacion

policor. Sa i përket fshatit Karaqevë, problemet kanë qenë të mëhershme. Në kufirin me Serbinë kompetencat edhe më tutje mbesin të KFOR-it dhe EULEX-it.

Sa i përket vjedhjes në Dhomën e dëshmimeve, kjo ka ndodhur më tepër se një vit. Me këtë çështje tani shumë ngushtë po merret EULEX-i.

Nuk kam detaje në lidhje me këtë, por ata kanë zhvilluar disa intervista të shumë individëve dhe së shpejti do të ketë rezultate konkrete.

Në procesin e liberalizimit të vizave kusht kryesor ka qenë të kemi marrëveshjen për ripranimin dhe strategjinë për ri-integrim, dhe këto veç i kemi plotësuar.

Me Malin e Zi nuk do të kemi dilema për vendosjen e pikave kufitare, sepse kemi të dhëna kadastrale ku dihen shumë qartë pronat e shqiptarëve.

Me një vendim të UNMIK-ut më herët komuniteti serb u është lejuar përdorimi i këtyre targave për arsye politike dhe për shkak të pengesave që i kanë. Gjithmonë atyre u është vazhduar një kohë e caktuar e përdorimit të atyre targave. Tani kjo çështje është kompetencë e jona dhe në mbledhjen e parë të bordit me EULEX-in, për sundimin e ligjit do ta paraqesim propozimin tonë. Ky propozim do të jetë që të afatizohet tre deri në gjashtë muaj çështja për pajisjen me targa, ndërsa brenda dy muajve do të fillojmë prodhimin e targave të Republikës së Kosovës.

Radmilla Vujović – Kur thashë më herët të fitohet besimi i qytetarëve te Policia e Kosovës, unë nuk kam menduar vetëm për komunitetin serb. Unë jetoj në Prishtinë dhe bëj pjesë në komunitetin serb por nuk e ndiej vetën të pasigurt. Por, sido që të jetë, nuk ekziston një ditë që nuk ndodh diçka e sidomos në mbrëmje. Ndodhin raste të ndryshme të vjedhjes, thyerjes së veturave, dhe për këtë arsye unë thashë që Policia duhet të funksionoj në mënyrë sa më praktike. Policia në këto lagje është prezent veç kur ka ngecje në trafik, dhe kjo do të duhej të ndodhte kështu. Policia e Kosovës do të duhet të jetë më prezent dhe më afër qytetarëve.

Bajram Rexhepi – Qasja në Policinë e Kosovës ka ndryshuar. Në të kaluarën Policia e Kosovës ka patrulluar vetëm me automjete, ndërsa tani ata do të kenë kontakte të vazhdueshme me qytetarë dhe siguria do të jetë më e lartë. Njëkohësisht kërkohet edhe bashkëpunim nga qytetarët me Policinë e Kosovës.

Kryetari i Komisionit – Ne jemi shumë të kënaqur me raportin e paraqitur nga ju. Do të jemi të gatshëm për bashkëpunim në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Po ashtu, do të kemi parasysh edhe rritjen e mbikëqyrjes parlamentare që paraqitet si një nga sfidat e raportit të progresit, dhe për këtë arsye do të kërkojmë të jemi më të përkushtuar.

Dëgjimi publik përfundoi në orën 11:30.

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetari i Komisionit
Rrustem Mustafa

